



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:007800  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05871290

CAP.nr.779/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, nga gjyqtarja individuale Nora Bllaca Dula, në çështjen përmbarimore të kreditorit KESCO Sh.A., me seli në P....., kundër debitorit N.H me adresë Rr. “.....” nr....., P....., lidhur me pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.5/2023, të datës 22.11.2023, me datë 24.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit N.H me adresë Rr. “.....” nr....., P....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.5/2023, të datës 22.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.5/2023, të datës 22.11.2023, ka vendosur si në vijim: “REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit N.H nga P....., i ushtruar kundër urdhrorit përmbarimor P.Nr.417/22 të datës 15.12.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat K.M, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë”.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori duke mos theksuar shkaqet e parapara me dispozitat ligjore, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë të bazuar ankesën ndërsa aktvendimin e atakuar ta ndryshojë duke e refuzuar propozimin për përmbarim të

kreditorit ose që ta anulojë aktvendimin e shkallës së parë dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe në rivendosje.

Ankesa e debitorit i është dorëzuar kreditorit për përgjigje, por i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

*-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datë 13.12.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste DPR ..... të datës 13.12.2022, me të cilin ka kërkuar që të caktohet përmbartimi dhe në emër të përmbushjes së obligimit të pa paguar për konsumin e energjisë elektrike për periudhën nga data 04.05.2014 e deri me datën 10.11.2022, në shumë prej 3.593,84 € Euro, me kamat-vonesë prej 8% duke filluar nga dita e kalimit të afatit prej shtatë ditësh për pagesë deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës së përmbartimit.

Përmbartuesi privat me urdhrin P.nr.417/22 i datës 15.12.2022, ka lejuar propozimin për përmbartim të kreditorit, sipas dokumentit autentik-ekstraktit nga librat e kontabilitetit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor si të pabazuar, duke theksuar se fillimisht nuk është kontestuese se debitori është shfrytëzues i energjisë elektrike mirëpo ka theksuar se aq sa ka shpenzuar rrymë edhe ka paguar, mirëpo kjo faturë që i ngarkohet nuk është faturë që duhet ta paguaj debitori për shkak se ky nuk është shpenzues i njehsorit elektrik që i përshkruhet se është i tij dhe që e ka shfrytëzuar për qëllimet e biznesit apo familjar. Ka shtuar se nuk e ka të qartë se pse i është regjistruar atij edhe pse ai nuk e ka harxhuar atë rrymë. Ka shtuar se ka paraqitur edhe padi ndaj kreditorit për këtë çështje se pse debitorin e ngarkojnë me këtë borxh edhe pse pikërisht është regjistruar njehsori elektrik debitorit. Rrjedhimisht i ka propozuar gjykatës që prapësimin ta aprovoj në tërësi si të bazuar. Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, në të cilën ka theksuar se kundërshtimi i debitorit është i pabazuar. Rrjedhimisht, i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe të pa-argumentuar.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin jashtë seancës ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.5/2023, të datës 22.11.2023, e ka refuzuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në bazë të dokumentit përmbartimor – ekstraktit të verifikuar nga librat afariste për pagesat e shërbimeve për shërbime publike – furnizim me energji elektrike DPR-....., të lëshuar nga kreditori KESCO Sh.A., për periudhën nga data 04.05.2014 deri me 10.11.2022 rezulton se debitori me urdhrin e përmbartuesit privat

është detyruar t'i paguaj kreditorit shumën prej 3,590.63 Euro, me kamatë 8% duke filluar nga data e arritjes për pagesë e deri në pagesën definitive. Gjykata vlerëson se në rastin konkret ekstrakti nga librat afarist - Kartela financiare e konsumatorit në fjalë ka cilësinë e dokumenteve të besueshme dhe paraqesin titull përmbartues në kuptim të nenit 21, lidhur me nenin 22 paragrafi 1, pika 1.1, neni 24 paragrafi 1, kështu që përmbartuesi privat drejtë ka vepruar kur e ka lëshuar urdhrin përmbartimor në bazë të dokumentit përmbartues – ekstraktit të verifikuar nga librat afariste për pagesat e shërbimeve për shërbime publike – furnizim me energji elektrike DPR-90096167. Sa i përket pretendimeve të tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, gjykata të njëjtat i gjeti si të pabazuara duke qenë se asnjëra prej tyre nuk ishin të mbështetura as edhe në një provë materiale.

Në rastin konkret debitori në prapësimin e tij nuk ka ofruar asnjë provë dhe asnjë pretendim që bie në kërkesat ligjore të nenit 71 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore. Rrjedhimisht, deklaratimet e debitorit nuk paraqesin asnjë nga arsyet e parapara në dispozitën e nenit 71 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore. Përfundimisht, nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhrin përmbartimor në këtë çështje përmbartimore, të përcaktuara me dispozitat e nenit 71 paragrafi 1, pika 1 deri në pikën 12, të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste, për pagesa të shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç është Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste DPR 90096167 dhe se i njëjti është i përshtatshëm për përmbartim pasi që përmban të gjitha kërkesat nga neni 29 paragrafi 1 dhe nën paragrafi 3 të LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimi ankimor i kreditorit se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore (për të cilën në arsyetim të ankesës nuk është thirrë), kjo gjykatë thekson se dispozitivi i aktvendimit është krejtësisht i qartë, i kuptueshëm e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit.

Lidhur me arsyetimin e aktvendimit, gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur me korrektësi dispozitave që përcaktojnë strukturën dhe përmbajtjen e aktvendimit, ndërsa në mënyrë specifike arsyetimi i aktvendimit në vetvete paraqet një përmbajtje koherente me rrjedhë logjike edhe për gjendjen e fakteve të konstatuara nga ana gjykatës së shkallës së parë.

Është edhe vlerësim i gjykatës ankimore se në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit nga librat afariste, të cilën kreditori i ka bashkangjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarim, janë të plotësuara të gjitha kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit të propozuar, ngase ekstrakti në bazë të të cilit është caktuar përmbarimi rezulton se është në origjinal, i njëjti është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori dhe nga ajo mund të dihet kërkesa dhe shuma që duhet të realizohet, e cila ligjërisht paraqet bazë juridike, për caktimin e përmbarimit, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsyeje se:

Nga neni 245 par.1 të të njëjtit ligj parashihet citoj “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij, Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve të pjesëmarrësve në marrëdhënien e detyrimeve ose në bazë të ligjit*”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, e duke u bazuar në këtë gjendje faktike, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale dhe ka vërtetuar se prej datës 04.05.2014 e deri me datën 10.11.2022 debitori ka borxhin për shfrytëzimin e energjisë elektrike të shfrytëzuar në shumën prej 3.593,84 €, andaj gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar, për të cilën Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshme

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore ka ndërmarrë veprime, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Gjykata e Apelit i ka shqyrtuar edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës ankuese, por që vlerësoi se nuk kanë relevancë për të vendosur ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2023:007800  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05871290

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CAP.nr.779/2024, me datë 24.06.2024

Gjyqtarja,  
Nora Bllaca Dula, d.v.